



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 156 Prot

Tiranë, më 25/11/ 2008

VENDIM Nr. 15 dt. 20.11.2008

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.11.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, mbi bazen e procesverbalit të mbledhjes dt. 20.11.2008. bashkangjiur.

VENDOSI:

Të miratojë:

1. Paketën e projekteve konservuese të hartuara nga ZAKPA Bylis.
 - a) Ndërhyrje konservuese në termën romake, pranë bazilikës C- Bylis.
 - b) Ndërhyrje konservuese në banesën romake, pranë bazilikës B-Bylis.
2. Paketën e projekteve të mirëmbajtjes të hartuara nga ZAKPA Apolloni
 - a) Projekt për evidentimin dhe pastrimin e muft të Akropolit.
 - b) Projekt për evidentimin dhe ekspozimin e tempullit në kuotën 104.
 - c) Projekt për pastrimin e sterës antike të njohur si "Pusi i Gjoncës"
 - d) Punime restauruese dhe rrethimi i termave antike në Apolloni.
3. Ambiente për vendosjene e biletarisë në kalanë e Gjirokastrës.
4. Projekti i konservimit të mozaikut të bazilikës në "Tepe", Elbasan.
5. Projekti i punimeve konservuese e restauruese në bazilikën e Tiranës.
6. Paketën e projekteve të mirëmbajtjes të hartuara nga DRKK, Tiranë.
 - a) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Ura e Brarit, Dajt, Tiranë
 - b) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Brarit, Dajt, Tiranë
 - c) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Gjon Pagëzorit, Derven, Krujë.
 - d) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Shën Mërisë, Mamurras.
 - e) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Shën Kollit, Krutje.
 - f) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Ura e Tabakëve, Tiranë
7. Të miratojë projekt idenë fituese të Projektit për Rehabilitimin e sheshit "Skënderbej", me kushtet e mëposhtme:
 - a) Të mos lejohet ndërtimi i 2 ndërtesave të reja përkatësisht në aksin e Bulevardit "Zogu i Parë", dhe midis Muzeut Kombëtar dhe Bankës së Shqipërisë
 - b) Shtrimi i sheshit të bëhet me pllakat tradicionale, me të cilat janë shtruar edhe akset që nga Universiteti i Tiranës deri tek Stacioni i Trenit.
 - c) Pendenca e sheshit të propozuar (pjerrësia), të mos kalojë 1%.

8. Të miratojë heqjen e statusit monument kulture banesës së Hutajve, Tiranë, e cila nuk ekziston
9. Projektin për disa restaurime të objekteve në muzeumin kombëtar Onufri dhe Etnografik, Berat.
10. Projekt idenë për ikonat e muzeut Onufri, Berat në lidhje me dokumentimin multispektral në ed afër, makro dhe mikro fotografike për restaurimin dhe ruajtjen e tyre. (Pas përfundimit të analizave, është i detyrueshëm botimi i rezultateve.)

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
YLLIPANGO



Sekretari i KKR
Besim Lila